



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 701 prot.

Tiranë më 20.04.2018

**REKOMANDIM**

Nr. 18, datë 20.04.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE NË SISTEMIN PËRMBARIMOR**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesve, Përmbaruesve Gjyqësor,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrave përkatës të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria e Hetimit Administrativ ka kryer hetime administrative pranë 20 kontrolluesve, nga të cilët 17 prej tyre ushtrojnë funksionet e aktivitetit si Përmbarues Gjyqësor Privat dhe 3 Zyra Përmbarimore Shtetërore në Tiranë, Vlorë dhe Elbasan, me objekt kontrolli:

- Zbatim i Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesve të cilët ushtrojnë veprimtarinë në sistemin përmbarimor.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Përmbaruesit Gjyqësor Privatë dhe Shtetërorë janë kontrollues, pavarësisht formës së organizimit të aktivitetit të tyre si "Person Juridik" apo "Person Fizik". Si kontrollues, ata mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale për kategoritë "punonjës", "vizitorë", "debitor-kreditor", "subjekte të dhënash" etj., për të cilët është marrë vendim ekzekutimi.

Përmbartuesit Gjyqësorë, në ushtrim të detyrës së tyre, kryejnë shërbime përmbartimore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe të titujve ekzekutivë sipas rasteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Drejtoria e Hetimit Administrativ, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, është asistuar nga përfaqësuesit e kontrolluesve, të cilët në çdo rast janë njoftuar para datës së inspektimit me Urdhrat përkatës të Komisionerit, për kryerjen e hetimeve administrative.

Nga inspektimet e ushtruara në vend dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga përfaqësuesit e kontrolluesve, është konstatuar se:

1. Një numër i konsiderueshëm kontrolluesish nuk kanë "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që kryejnë, por e kanë kryer këtë detyrim menjëherë mbas njohjes me Urdhrin përkatës të kontrollit.

Zyra e Komisionerit konkludon se, konstatimi përbën shkelje administrative të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

*"1. - Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.*

2. Disa prej kontrolluesve të cilët e kanë organizuar aktivitetin e tyre në formën e "Personit Juridik", nuk disponojnë Rregullore specifike për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit konkludon se, konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar: "2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera." dhe Vendimit Nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".

3. Nga verifikimi i dokumentacionit të personelit, është konstatuar se një pjesë e kontrolluesve të cilët e kanë organizuar aktivitetin e tyre në formën e "Personit Juridik", nuk kanë marrë masa për "ruajtjen e konfidencialitetit" nga punëmarrësit e tyre, të cilët për shkak të detyrës apo pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, me Vendimin Nr. 6 datë 05.08.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale", ka miratuar modelin standard të "Deklaratës së Konfidencialitetit", duke i mundësuar kontrolluesit një mekanizëm për të angazhuar nëpunësit e tij në "ruajtjen e konfidencialitetit", në lidhje me të dhënat që ata aksesojnë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar: "Kontrolluesit,



*përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj” dhe Vendimit Nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.*

4. Nga verifikimi i ambienteve si hyrjet, zyrat, ambientet e vizitorëve, korridoret e administratës etj., në të cilat kontrolluesit ushtrjnë aktivitetin, është konstatuar se disa kontrollues mbikëqyrin këto ambiente nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).

Nga hetimet administrative të ushtruara, Zyra e Komisionerit vëren se disa prej zyrave përbarimore nuk informojnë subjektet e të dhënave “vizitorë” dhe “punëmarrës”, mbi përpunimin e të dhënave personale “imazhe-video” nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre. Edhe në ato zyra ku është gjetur tabela informuese për prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), është konstatuar se ato nuk janë sipas modelit standard të miratuar me Udhëzimin Nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”. Modeli i tabelës informuese, është një mekanizëm standard për t’ju mundësuar subjekteve të të dhënave informimin mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste cënimi.

Konstatimi në lidhje me mbikëqyrjen e zyrave të punonjësve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 5 (“I/b - në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime”), nenit 6 (Kriteret ligjore për përpunimin) të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr.11 (pika 10.2) datë 08.09.2011 të Komisionerit, mbi “Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”: “Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës. Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret në tualete, dhomat e ndërrimit apo vende të tjera të ngjashme, ose në dhomat e punës të caktuara për përdorim personal të punonjësve”.

Zyra e Komisionerit vëren se, mungesa e informimit të subjekteve të të dhënave lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 18 (pika 1) të Ligjit: “Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij”.

5. Konstatohet se kontrolluesit nuk kanë vendosur politikat e privatësisë në portalet zyrtare të tyre.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 pika 1 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.



Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit online në internet, ka detyrim që të publikojë *"Politikat e Privatësisë"*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Informacioni i publikuar në *"Politikat e Privatësisë"*, duhet të informojë subjektet e të dhënave që vizitojnë këtë portal, në lidhje me fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, kategoritë e të dhënave që përpunohen, të drejtat e subjekteve të të dhënave si dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë;

Publikimi i *"Politikave të Privatësisë"* përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vëren se konstatimet e mësipërme në tërësinë e tyre përbëjnë shkelje të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar por, duke parë reagimet e menjëhershme të subjekteve të kontrolluara në zbatimin e detyrimeve ligjore, Zyra ka aplikuar kryesisht daljen me akte si Rekomandim ose Urdhër.

Mbështetur në procedurat administrative, në të gjitha rastet janë mbajtur procesverbale për çdo kontrollues, referuar Udhrit përkatës të kontrollit dhe subjektit të kontrolluar i është lënë një kopje e këtij procesverbali. Si rezultat i gjithë veprimtarisë së kontrolluesve, Zyra e Komisionerit ka dalë me 7 Rekomandime, 1 Urdhër dhe 1 Vendim, akte të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

Lidhur me problematikat e trajtuara më sipër, Zyra e Komisionerit çmon që në zbatim të Ligjit Nr. 10031/2008 *"Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"* dhe Ligjit Nr. 8730/2001 *"Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor"*, të vihet në dijeni Ministria e Drejtësisë në lidhje me shkeljet administrative të konstatuara. Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 pika 1 *"a/1"* dhe 32 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar,

## REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesit, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.11 datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi *"Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat"*, të ndalojnë mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe të shkatërrojnë të dhënat personale të mbledhura nëpërmjet sistemit të video-survejjimit të regjistruara në mënyrë jo të ligjshme.
2. Kontrolluesit, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të informojnë subjektet e të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste cënimi, nëpërmjet tabelave informuese sipas



modelit standard të miratuar nga Komisioneri me Udhëzimin Nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

3. Kontrolluesit, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, të publikojnë Politikat e Privatësisë në portalet respektive zyrtare, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Kontrolluesit, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë, të cilët nuk kanë "Njoftuar" në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të "Njoftojnë" Zyrën e Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale për të cilat janë përgjegjës.
5. Kontrolluesit, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masa të përshtatshme për hartimin dhe zbatimin e Rregullores për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".
6. Kontrolluesit, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrin masa për ruajtjen e konfidencialitetit nëpërmjet nënshkrimit të "Deklaratës së Konfidencialitetit" nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
7. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit të kryejnë plotësimin e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim brenda afatit 60 ditor nga momenti i marrjes dijeni, dhe të njoftojnë me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
8. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesit, Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
9. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 20.04.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi